



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 128/2013
Prishtinë, më 24.12.2013, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala S-I

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Etem Arifi, anëtarë.

Munguan: Shaip Muja dhe Hashim Deshishku.

Të ftuar: znj. Edita Tahiri, zëvendëskryeministre dhe z. Fadil Ismajli, ministër i Zhvillimit Ekonomik.

Pjesëmarrës të tjerë: Afrim Hoti – MZHE, Blerta Bejtullahu – EUSR/EU office, Elona Cecelia – ZVKM, këshilltare, Gazmir Raci – ZVKM, këshilltar, Visar Xani – ZVKM, këshilltar, Arben Sylejmani, gazetar “Jeta në Kosovë”, Ukë Gashi –ZPRK, Gurjeta Zeka - Kuvendi i Kosovës, Burim Ejupi – INDEP, Naim Bejtullahu – KOSST, Avdyl Pajaziti - Klan Kosova, Kushtrim Ahmeti - KTV, Naim Krasniqi- Radio Dukagjini.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 16.12.2013;
3. Raportim i përfaqësuesve të Qeverisë lidhur me marrëveshjet për energjinë me Serbinë;
4. Të ndryshme;

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.12.2013;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 16.12.2013, u miratua pa vërejtje.

3. Raportim i përfaqësuesve të Qeverisë lidhur me marrëveshjet për energjinë me Serbinë;

Kryetari – Tha se për sot kemi të ftuar znj. Edita Tahiri, zëvendëskryeministre dhe z.Fadil Ismajli, ministër i zhvillimit ekonomik, për të raportuar lidhur me marrëveshjen për energjinë në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai njoftoi se fusha e energjisë bie mbi fushëveprimtarinë e këtij Komisioni. Para se t’ua japë fjalën të ftuarve, kryetari Pajaziti, falënderoi zëvendëskryeminstren dhe ministrin për përgjigje në ftesë.

Edita Tahiri, zëvendëskryeministre e Qeverisë së Kosovës, në fjalën e saj foli për rëndësinë e marrëveshjes në planin ndërkombëtar dhe në planin e fqinjësisë së mirë. Marrëveshja për energjinë është negociuar për 3 vjet, që nga viti 2011, dhe tani është arritur marrëveshja në nivel të kryeministrave. Me këtë marrëveshje, Serbia e ka njohur Republikën e Kosovës në fushën e energjisë. Me këtë marrëveshje hiqen strukturat ilegale dhe po ashtu hiqen ndërhyrjet e Serbisë. Me marrëveshjen për energji krijohet një bashkëpunim mes KOSST-it dhe autoritetit homolog në Serbi. Marrëveshja po ashtu parasheh heqjen e pengesave në nivel ndërkombëtar, për pjesëmarrje të barabartë. Marrëveshja parasheh të ketë një liberalizim të tregut të furnizimeve deri në fillim të vitit 2015. Tregu ynë mund të hapet për furnizim, por nuk mund të hapet për distribuim, distributori i vetëm është dhe do të jetë KEDS-i. Me këtë marrëveshje parashihet që KEDS-i të ketë qasje në pjesën veriore të vendit. Po ashtu do të themelohet një kompani komerciale, e cila do të bashkëpunojë me KEDS-in. Pjesë e marrëveshjes është marrja e kontrollit në nënsistemin në Vallaç nga KOSST-i. Pra me këtë marrëveshje do të normalizohet gjendja e energjisë. Ajo tha se do të diskutohet plani i implementimit në raport me zbatimin e marrëveshjes dhe se ka përparime në këtë proces dhe në fund të janarit pritet të finalizohet dhe të fillojë zbatimi. Kjo marrëveshje është marrëveshje që mbështetet nga BE-ja dhe garantohet prej saj. E konsideroj si obligim kushtetues pjesëmarrjen në negociata. Në fund të fjalës së saj, znj.Tahiri tha se me këtë marrëveshje hiqen operatorët ilegale, KOSST-i ec drejt integritit në organizata evropiane dhe më gjerë.

Fadil Ismajli, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, u shpreh se nuk ka qenë pjesë e grupit teknik të bisedimeve. Ai tha se Komuniteti i Energjisë në Vjenë ka gjetur shkellje të Traktatit nga Serbia, dhe këtë rast e ka fituar Kosova, sepse Kosova duhet të ketë kufijtë e saj energjetik. Të hyrat që do të vijnë nga transiti, shkojnë te konsumatori përmes uljes së tarifave. Me këtë marrëveshje, me garantimin e BE-së, hiqen barrierat në anëtarësimin e Kosovës në mekanizmat evropianë. Me marrëveshjen për implementim do të përcaktohen saktë afatet kohore dhe ato pritet të përmbyllen brenda vitit 2014. Me ndërtimin e linjës së interkoneksionit me Shqipërinë, nuk do të jemi të varur nga Serbia në aspektin energjetik. Me këtë segment energjetik, Kosova po bëhet nyje e rëndësishme energjetike. Shqipëria nuk ka pse të bëjë marrëveshje të interkoneksionit me Serbinë sepse nuk është fqinje e saj. Njëherësh, ndërtimi i linjës së interkoneksionit me Shqipërinë krijon mundësi për hapje të tregut. Duke iu referuar kompanisë në pjesën veriore të vendit, ai tha se një furnizues apo shpërndarës i vogël, si është

kjo kompani, vështirë se mund të qëndrojë në treg dhe shprehi mendimin se gradualisht kjo kompani do të shkrihet.

Kryetari – Lidhur me marrëveshjen për themelimin e kompanisë në pjesën veriore, pyeti se a është biseduar për detajet? Pas themelimit a do të mund të themi se kemi vetëm një shpërndarës? A do të ketë vonesa apo diçka më pozitive nga ana e Serbisë?

Edita Tahiri, zëvendëskryeministre e Qeverisë, duke iu përgjigjur pyetjes tha se marrëveshja e bënë të qartë që në Kosovë nuk mund të ketë distributorë tjetër. Sipas ligjeve tona, në Kosovë ka vetëm një distributor publik dhe nuk mund të ketë tjetër. Kompania e themeluar duhet të ketë përgjegjësi të mirëmbajtjes dhe komerciale dhe kompania duhet të regjistrohet në MTI. Kjo kompani do të bashkëpunojë me KEDS-in si nënkontraktor. Edhe gjatë negociatave kur është prek KEDS-i, i kemi kontaktuar dhe kemi kërkuar prej tyre rekomandimet. Po ashtu përveç rekomandimeve që na kanë dhënë KEDS-i në vazhdimësi, tha ajo përmes video konferencave i kemi njoftuar pronarët e KEDS-it për çdo gjë.

Myzejene Selmani –Tha se ne e kemi ftuar znj. Edita Tahiri, si përfaqësuese e Qeverisë dhe si profesioniste të na njoftojë lidhur me marrëveshjen për energjinë. Po ashtu, ajo tha se ne dëshirojmë të bashkëpunojmë dhe të shohim se si mund t'ju ndihmojmë në këtë proces. Ajo iu referua pikës 1, të marrëveshjes dhe tha se te dyja palët duhet ta respektojnë. Po ashtu, duke iu referuar pikës 4, përkatësisht afatit të përcaktuar për hapjen e tregut, tha se me legjislacionin ekzistues, nuk mund të hapet tregu aq shpejt. Kompania e themeluar për çështje komerciale, sa po shihet është vetëm si nënkontraktor edhe pyeti se kjo marrëveshje a do të prek operatorin e rigjenerimit të ri?

Ramiz Kelmendi – Tha se Serbia asnjëherë nuk do të përkrah Kosovën. Sipas marrëveshjes do të krijohet një kompani, duke ju lejuar shitja dhe blerja e energjisë, por duhet të kemi kujdes që mos të krijohet një ndarje fizike dhe me këtë rast pyeti: kompania a do të jetë private apo publike apo si do të jetë? Sa do të kemi rrugë alternative për furnizim me energji elektrike?

Teuta Sahatqija – Përhëndeti fillimin e projektit të interkoneksionit me Shqipërinë dhe tha se kjo mundëson pavarësinë energjetike. Ajo pyeti se sa pritet të zgjatë ky projekt dhe kur do të jemi të pavarur në energji? Duke iu referuar Rezolutës së Kuvendit për negociatat, ajo tha se me këtë rezolutë thuhet që në bisedime të marrin pjesë edhe anëtarët e komisioneve parlamentare. Komisioni jonë nuk ka pas ndonjë ftesë, dhe pyeti pse nuk është konsultuar Komisioni? Ajo kërkoj sqarime për nënstacionin në Vallaç. Lidhur me hapjen e tregut, tha se derisa thuhet se do të ketë vetëm një distributor, si do të hapet tregu, çka do të thotë kjo? Duke iu referuar pikave 4 dhe 5 të marrëveshjes, pyeti se a do të thotë që kjo kompani do të jetë një asociacion energjetik. Sipas marrëveshjes, thuhet që kompania e re do të bëjë marrëveshje me KOSST-in e jo me KEDS-in. Ajo tha se më tepër po e ndryshon vetëm emrin nga “Elektrokosmet” sesa po integrohen konsumatorët. Ajo pyeti se kur pritet të përfundojë plani i veprimit, dhe tha se shpresoj që kjo kompani do të ketë afatin. Ajo u shpreh se krijimi kësaj kompanie duket si rezon politik e jo ekonomik.

Visar Ymeri – Duke iu referuar fjalës së zv.kryeministres se negociatat me Serbinë janë obligim kushtetues edhe për integrim evropian. Deputeti Ymeri, tha se e para gjë kushtetuese është ruajtja e sovranitetit e mandej integrimi evropian. Ai tha se kufiri energjetik është i njohur nga Traktati e jo nga marrëveshja. Duke iu referuar pikave të marrëveshjes, tha se dy pikat e para janë pika lehtësuese, ndërsa pika 3, 4 dhe 5, janë çështje kryesore. Ai iu duke iu referuar pikës 3 të marrëveshjes, pyeti se çka nënkupton dhe çfarë bashkëveprimi mes autoriteteve të dyja palëve është i nevojshëm për lëshimin e licencave? Duke iu referuar pikave 4 dhe 5, pyeti se kjo kompani a e bënë lidhjen e konsumatorëve për vete apo për KEDS-in? Pse ka nevojë Kosova të

merret vesh me Serbinë për hapjen e tregut? Ai tha se pika 4, kryekëput ka të bëjë me themelimin e kompanisë së re, dhe kjo hapje e tregut ka të bëjë me akomodimin e kësaj kompanie. Përveç tjerash, kjo kompani do të ketë të drejtë të blejë dhe të shesë energji. Kufiri energjetik i KOSST-it po dëmtohet me krijimin e kufirit të brendshëm. Themelimi i kësaj kompanie do të ndikojë që Serbia të hyjë në treg edhe në Shqipëri përmes kësaj kompanie në veri të vendit.

Edita Tahiri, zëvendëskryeministre e Qeverisë, duke iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, tha se në dialogun e Brukselit, nuk kemi shkuar vetëm për të plotësuar synimet eurointegruese dhe fqinjësisë së mirë. Ne me këtë, i jemi përgjigjur rezolutës së OKB-së që ka ftuar për dialog, si dhe në bazë të obligimeve tona edhe nga Qeveria edhe nga rezoluta e Kuvendit. Ne kemi përparuar në proceset integruese, kemi marrë MSA-në, dhe MSA-ja i jepet vetëm shteteve. Sepse Kosova ka hapur marrëdhënie si shtet me BE-në. Me këtë dialog kemi zbutur qëndrimin e shteteve që ende nuk na kanë njohur. Ne kemi shkuar në negociata t'i heqim strukturat paralele nga veriu. Marrëveshja në përgjithësi është kontribut për normalizimin dhe fuqizimin e sovranitetit. Kompania e re do të regjistrohet sipas ligjeve të Kosovës. Kompania do të hyjë në bashkëpunim me KEDS-in, dhe asnjë marrëveshje bashkëpunimi nuk është e plotfuqishme pa miratimin e ZRRE-së. Ajo tha se dallojnë kompanitë distributive dhe ato që kryejnë shërbime. Sa i përket çështjes së liberalizimit, ajo tha se ZRRE-ja ka qenë pjesë e negociatave dhe do të jetë deri në fund. Po ashtu, tha se liberalizimi mund të fitohet edhe më herët. Ajo tha se nuk ka distributorë tjetër përveç KEDS-it. Kompania e re do të jetë për furnizim dhe shërbime, por jo distributive, kështu e thotë edhe ligji i Kosovës. Kjo kompani do të jetë private, u përgjigj ajo në pyetjen se a do të jetë kompania publike apo private. Sa i përket pjesëmarrjes së deputetëve në negociata në Bruksel, ajo tha se në kohën kur kanë filluar negociatat ajo u ka dërguar letër partive politike që t'i bashkëngjiten ekipit negociator dhe po ashtu edhe deputetëve të LDK-së, z.Lutfi Haziri dhe z. Sadri Ferati, por nuk ka marrë përgjigje pozitive. Pra me këtë kemi dashur të kemi një spektër të gjerë të përfshirjes në ekipin negocues. Ajo i ftoi deputetët të jenë pjesë e negociatave për planin e zbatimit të marrëveshjes dhe tha se ekipi negocues është i hapur. Sa i përket pyetjes rreth përkrahjes dhe konstruktivitetit të Serbisë, ajo tha se në marrëveshje thuhet që të dyja shtetet nuk do ta pengojnë njëra-tjetrën në integrimet evropiane. Ajo njoftoi se në kornizën e negociatave të Serbisë me BE-në, Kosova është kusht për Serbinë që të ecë drejt integriteteve evropiane. Serbia nuk mund të bëhet anëtare e BE-së, pa e njohur Kosovën, tha në fund znj. Edita Tahiri.

Fadil Ismajli, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, tha se Autoritetet Rregullative, kushtimisht duhet të bashkëpunojnë jo vetëm në raportet Kosovë-Serbi, por në përgjithësi. Bashkëpunimi është i nevojshëm që të sigurohet njohja e licencave të njëri tjetrit. Ai tha se secila kompani në përgjithësi mund të kontraktojë shërbime, prapa çdo lidhjeje të konsumatorit qëndron KEDS-i, si pronar i të gjitha aseteve. Operatori i ri ka obligim ndaj KEDS-it. Ai u përgjigj se çdo marrëveshje mund të ketë mirëkuptim për ecje përpara dhe mbi këtë bazë mendohet të bëhet hapja e tregut më 1 korrik 2014, edhe pse shtetet e Evropës juglindore e kanë deri më 1 janar 2015. Sa i përket pyetjes për projektin e interkoneksionit me Shqipërinë, ai tha se jam shumë i kënaqur që është bërë marrëveshja e interkoneksionit me Shqipërinë. Ai tha se mekanizmat e energjisë të Serbisë e kanë njohur Kosovën me këtë marrëveshje. Serbia është munduar që ta paraqesë veten si pronare të aseteve në Kosovë dhe të përfitojë. Serbia nuk mund të ketë veto në integrimet energjetike të Kosovës. Sa i përket qasjeve alternative, ai tha se në Kosovë janë 4 lidhje interkonektive edhe kjo me Shqipërinë e forcon qasjen alternative. Ai tha se furnizuesi është aset i lirë, nuk i ka asetet por vetëm biznesin, dhe paguan KEDS-in për shfrytëzimin e aseteve, dhe KOSST-in për shërbimet e veta.

Edita Tahiri, zëvendëskryeministre e Qeverisë, tha se kemi një pyetje nga deputetja Selmani se si do të bëhet realizimi i planit për implementim dhe kush do të jetë në grup? Znj.Tahiri tha se

bën kërkesë në Ministrinë që mbulon këtë fushë dhe Ministria dërgon personat më kompetentë. Po ashtu në kuadër të fushave mund të ftojme edhe ndërmarrje publike. Ky grup nën udhëheqjen time tha ajo, e ka rolin e realizimit të negociatave, implementimit dhe monitorimit. Ajo sqaroi se Sekretariati i Athinës ka marrë vendim që Serbia ka bërë shkelje të Traktatit.

Teuta Sahatqija – Tha se sipas sqarimeve, po thuhet që kompanie e re e themeluar kryen shërbime teknike, ndërsa tha se pika 5, e marrëveshjes pjesa e parë nuk më brengos, por pjesa tjetër ku thuhet se kjo kompani e re lidh marrëveshje me KOSST-in, është brengosëse, sepse kjo pjesë i jep të drejtë të blejë dhe të shesë energji. Po ashtu, ajo pyeti se kush është pala e tretë sipas pikës 5. Po ashtu pyeti se ku do të shkojë faturimi? Me rezolutën e Kuvendit u jepet drejt deputetëve të marrin pjesë në bisedime, por deri më tani nuk ka pasur pjesëmarrje, nuk jemi ftuar.

Visar Ymeri - Duke iu referuar pikës 3, pjesës së fundit të marrëveshjes, tha se kjo mund të kuptohet se KEDS-i, KEK-u dhe EPS-ja, mund të veprojnë në vendet e njëri- tjetrit. Ndërsa, sipas marrëveshjes, ai tha se furnizimin e ka kompania, ndërsa është nënkontraktore e KEDS-it, pra KEDS-i është i detyruar të bashkëpunojë me këtë kompani. Lidhur me hapjen e tregut, tha se pajtohet që mund të hapet edhe më herët, por duhet të jepet arsyeja pse Kosova po e hap më herët.

Ramiz Kelmendi – Pyeti se kompania e re në pjesën veriore a do të jetë shqiptare apo serbe apo çka?

Sala Berisha – Shala – Tha se të gjitha dilemat duhet të hiqen se marrëveshja nuk është mbi ligjin dhe pyeti se kur Kosova do ta marrë kodin e saj energjetik.

Edita Tahiri, zëvendëskryeministre e Qeverisë, tha se marrëveshja është në përputhje të plotë me ligjet e Kosovës. Ajo tha se marrëveshja për zbatim në letër, plani i zbatimit në letër dhe e treta realizimi i planit. Dy kompani bisedojnë si dy kompani të ndryshme, kur bëhet marrëveshja njëra është nënkontraktore. Sa i përket hapjes së tregut, ligji nuk ka baza etnike e as kompania nuk ka baza etnike. Lidhur me palën e tretë, ajo tha se nuk është fjala për palën e tretë pjesëmarrëse, por në nivel të bashkëpunimit të operatorëve.

Naim Bejtullahu, kryeshef ekzekutiv i KOSST-it, tha se në tregun e liberalizuar mund të jetë distributori pa konsumatorë, KEDS-i e ka rrjetin, si edhe KOSST-i e ka rrjetin. Ky treg tha ai punon mbi bazat e tregut të hapur. Asnjë furnizues nuk mund të punojë në Kosovë pa marrëveshje me KOSST-in. Ai tha se duhet t'u sigurojmë të gjithëve trajtim të barabartë, kjo është qasja ndaj palës së tretë, pra të njëjtën gjë e ka edhe distributori që në rastin tonë është KEDS-i.

Fadil Ismajli, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, tha se KEDS-i nuk është operator i cili del në treg, furnizuesit mund të dalin në treg dhe të konkurrojnë, kush po ofron energji më lirë.

Pas debatit Komisioni nxori

Konkluzion

Komisioni do të ftojë përfaqësuesit e Qeverisë që të raportojnë në lidhje Marrëveshjet me Serbinë, ne bazë të kërkesave të deputetëve dhe çështjeve të ngritura.

4. Të ndryshme.
Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Zenun Pajaziti